

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Blerje goma automjetesh”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 34913200-2
- **Vlera e fondit limit:** 1,688,466 (një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: *kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit të përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (gomisteri/servis) të përshtatshme brenda territorit të Bashkive respektive: Kamëz, Vorë, Tiranë ose Krujë. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

c. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 8, nenit 40, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme demonstrimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e gomave, garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin e gomave.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributori i autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve garantojnë AK-në se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallrave të kërkuara në cilësinë dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të gomave, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e këktij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: *Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet Teknike

Nr	Emertimi	Ngar kesë	Shpejtësia	Ngarkesa maksimale dhe presioni i fryrë					Të fryra	Të fryra	Tread	Sasia
				Standart	Dopjo	Teke			Seksioni	Thellesi		
		Index	Symbols	Rim					Diameter	Gjerësia	(mm)	
					(kg)	(kpa)	(kg)	(kpa)	(mm)	(mm)	(mm)	
1	245/70 R19.5	136/134	M	7.5	2120	825	2240	825	839	245	13	18
							Të fryra	Të fryra				
Nr	Emertimi	Ngar kesë	Shpejtësia	Standart	Standart Load	Të fryra	Overall	Seksioni	Tread			
		Index	Symbols	Rim	(kg)	Pressure	Diameter	Gjerësia	Thellesi			
						(kpa)	(mm)	(mm)	(mm)			
2	225/45 R17	94	W	71/2 J	670	290	634	225	7,8			16
3	195/65 R15	91	T	6 J	690	290	635	201	8,5			28
4	215/65 R16	102	H/T	61/2 J	850	290	686	221	8,8			4
5	245/75 R16	111	H/S	7 J	1090	250	774	248	8,7			8
6	235/45 R17	97	W/Y	8 J	730	290	644	236	7,9			12
7	255/45/18	103	Y	9J	1090	290	790	248	8.8			4

1. Gomat duhet të jenë të reja. Gomat nuk duhet te jenë të riveshura.

2. Të gjitha gomat duhet të jenë të prodhimit për përdorim 4 (katër) stinët.
3. Gomat të jenë të një prodhimi jo më parë se 10 (dhjetë) muaj nga data e lëvrimit.
4. Të përfshihet montim+balancim i gomave.
5. Në sipërfaqen anësorë të jashtme do të jenë të stampuara shkrimi i të dhënave:
 - Prodhuesi (Marka).
 - Emërtimi i gomës.
 - Përmasat (dimensionet) e gomës sipas porosisë të kërkuar.
 - Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë.
 - Struktura e gomës radiale.
 - Tipi i gomës (tubeless/ Tube Type).
 - Data e prodhimit.
 - Marka e prodhimit të jetë e standartizuar dhe certifikuar sipas certifikatave të Komunitetit European CEN ose ekuivalente, shoqëruar me indeksin 'E' sipas direktivave ECE.
6. Gomat e një dimensionit do të jenë sasia e kërkuar e të njëjtit tip prodhimi/ të të njëjtës markë.
7. Garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Afatet e lëvrimit:

E gjithë sasia e kërkuar do të lëvrohet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.